



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku i
Tehnologiju-Ministry of Education Science & Technology*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/ Cabinet of the Minister

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Emërtimi dhe riemërtimi i shkollave (institucioneve arsimore)

NUMËR: 10/2008

DATË: 26.05.2008

Në bazë të nenit 1.3 pika d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, nenit 42.1 të Ligjit të arsimit fillor dhe të mesëm në Kosovë, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë(MASHT) nxjerr këtë Udhëzim administrativ:

Neni 1

Qëllimi

Ky Udhëzim administrativ përcakton kriteret dhe procedurat për emërtimin e institucioneve parashkollore, të shkollave fillore, shkollave të mesme të ulëta dhe shkolla të mesme të larta (në tekstin e mëtejshme- shkolla).

Neni 2

Emërtimi i shkollës

Shkolla mund të emërtohet me

- a) emër personaliteti,
- b) emër gjeografik ose
- c) emër kuptimi.

Neni 3

Procedura

1. Këshilli i shkollës i bën kërkesë Drejtorisë komunale të arsimit me më së paku 3 propozime.
2. Për secilin propozim shkolla duhet dhënë arsyetimin me shkrim.
3. Nëse ka propozim të ndonjë personaliteti të shquar, shkolla, përpos arsyetimit me shkrim, duhet edhe dëshmi për jetën dhe veprimtarinë e tij.

Neni 4

Drejtoria komunale e arsimit

1. Drejtoria komunale e arsimit do ta rekomandoj njërin nga të propozuarit.
2. Rekomandimi i DKA-së duhet të arsyetohet me shkrim.
3. Kërkesa e kompletuar i dërgohet MASHT-it për emërtim të shkollës.

Neni 5

Ndërrimi i emrit

1. Arsyetimin për ndërrimin e emrit e përgatitë Këshilli i shkollës me të cilin duhet të pajtohet DKA-ja.
2. Procedura për riemërtimin e shkollës është e njëjtë me procedurën e emërtimit.

Neni 6

Pengesat

Një shkollë nuk mund të emërtohet me:

- a) emrin e personalitetit të gjallë dhe
- b) dy shkolla të një komune nuk mund të kenë të njëjtin emër.

Neni 7

Dispozitatkalimtare

Me hyrje në fuqi të këtij Udhëzimi administrativ shfuqizohen dispozitat e mëhershme që e kanë rregulluar këtë fushë.

Neni 8

Hyrja në fuqi

U.A. hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Enver Hoxhaj, ministër